



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DREJTORIA E METODOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT

PROGRAM TRAJNIMI

Tetor, 2021

Referuar “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Audituesve të KLSH-së” për vitin 2021, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 14 datë 08.02.2021, si dhe në përmbushje të nën objektivit mbi rritjen e kapaciteteve audituese të KLSH-së, përcaktuar në SZHI 2018-2022, gjatë muajit Tetor 2021, do të zhvillohet trajnimi mbi “Programin IDEA”, përgatitur nga Drejtori i Departamentit të Auditimit IT, si më poshtë:

Tema e trajnimit: “Programi IDEA”

Fokus grupet: Audituesit e rinj të Departamenteve të KLSH-së, të rekrutuar gjatë dy viteve të fundit
Vendi: Salla e trajnimeve, duke respektuar protokollet e sigurisë në mbrojtje të shëndetit.
Afati i trajnimit: 4 ditë trajnimi
Trajner: Kozma Kondakçi, Drejtor i Departamentit të Auditimit IT.

Data	Tema e trajnimit	Literatura e rekomanduar	Trajneri
25.10.2021	<ul style="list-style-type: none">- Njohuri të përgjithshme- Fillimi i punës me IDEA- Baza e të dhënave tipet e skedarëve- Importimi i të dhënave- Vlerësimi i bazës së importuar- Toolbar, taskbar në IDEA	<ul style="list-style-type: none">- IDEA program- Manual mbi përdorimin e IDEA- Video interaktive- Shembuj	Kozma Kondakçi

	- Përsëritje e ditës & video		
26.10.2021	<ul style="list-style-type: none"> - Përsëritje e ditës se mëparshme - Statistikat e shpejta të fushës - Shtresëzimi i skedarëve - Ekstraktimi i skedarëve - Editori i Ekuacioneve - Modelimi & krijimi i një numri rastësor - Bashkimi i skedarëve - Përsëritje e ditës & video 	<ul style="list-style-type: none"> - IDEA program - Manual mbi përdorimin e IDEA - Video interaktive - Shembuj 	Kozma Kondakçi
27.10.2021	<ul style="list-style-type: none"> - Përsëritje e ditës se mëparshme - Ngjitja i skedarëve - Data Extractions - Data Dublikate Key Detection - Gjetja e hendeqeve gap - Sort - Eksporti i të dhënave - Përsëritje e ditës & video 	<ul style="list-style-type: none"> - IDEA program - Manual mbi përdorimin e IDEA - Video interaktive - Shembuj 	Kozma Kondakçi
28.10.2021	<ul style="list-style-type: none"> - Përsëritje e ditës se mëparshme - Field manipulation - Krijimi i një fushe virtuale - Ndhma ne IDEA - Përshtatja toolbarit - Printimi dhe krijimi i raporteve - Historiku i veprimeve - Përsëritje e ditës & video 	<ul style="list-style-type: none"> - IDEA program - Manual mbi përdorimin e IDEA - Video interaktive - Shembuj 	Kozma Kondakçi

Lista e audituesve të cilët do të marrin pjesë në këtë trajnim

Nr.	Emër mbiemër	Pozicioni	Departamenti
1	Tomorr Asqeriu	Auditues i Parë	Auditimit të Buxhetit të Shtetit
2	Alfons Bushaj	Auditues i Parë	Auditimit të Institucioneve Qendrore
3	Delor Prosi	Auditues i Parë	Auditimit të Institucioneve Qendrore
4	Krisela Ngjela	Audituese e Dytë	Auditimit të Buxhetit të Shtetit
6	Armols Zykollari	Auditues i Parë	Auditimit të Institucioneve Qendrore
7	Anjeza Gjoci	Audituese e Dytë	Auditimit të Institucioneve Qendrore
8	Sadin Ahmagjokaj	Auditues i Parë	Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

9	Erand Rroboçi	Auditues i Parë	Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore
10	Bardhi Koçi	Auditues i Parë	Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore
11	Enkeled Greku	Auditues i Parë	Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
12	Edmond Doku	Auditues i Parë	Auditimit të Performancës
13	Darling Maqina	Auditues i Dytë	Auditimit të Performancës
14	Dritan Osmani	Auditues i Parë	Auditimit të Performancës
15	Eva Kasmi	Audituese e Parë	Auditimit të Performancës
16	Erjona Murataj	Audituese e Dytë	Auditimit të Performancës
17	Ardian Simoni	Auditues i Parë	Auditimit të Shoqërive Publike
18	Eriola Hoxha	Audituese e Parë	Auditimit të Buxhetit të Shtetit
19	Elisa Spahiu	Audituese e Dytë	Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore
20	Angjela Nesturi	Audituese e Parë	Auditimit të Institucioneve Qendrore

Elementët e trajnimit:

- **Skedulimi**
- **Zhvillimi**
- **Kontrolli**
- **Vlerësimi**

Që të realizohet një proces trajnimi optimal, duhet të plotësojmë disa kushte:

- Sigurimi i teknikës së nevojshme: Trajnimi do të zhvillohet në sallën e trajnimeve, duke respektuar rregullat anti Covid-19.
- Sigurimi i materialeve të nevojshme: Të gjithë audituesit, do të kenë akses të plotë mbi materialet të cilat do të jenë objekt i këtij trajnimi. Të gjithë personat që do të trajnohen duhet të kenë laptop me vete.
- Sigurimi i trajnerëve të aftë: Nga lista e trajnerëve është përzgjedhur si trajner z. Kozma Kondakçi, i cili ka kompetencën e duhur profesionale në drejtimet përkatëse të trajnimit.

Skedulimi i programit: Skedulimi i programit është bërë duke patur në konsideratë ngarkesën në punë të audituesve, por dhe realizimin e objektivave të trajnimit. Ky trajnim do të shtrihet në 4 ditë.

Zhvillimi i trajnimit: Zhvillimi i trajnimit, është konkretizimi i të gjitha etapave të mëparshme të procesit të trajnimit si; përcaktimi i nevojave, planifikim-programimi dhe skedulimi.

Në etapën e zhvillimit të trajnimit ndikojnë disa faktorë:

- Përgatitja e lektorëve, sa ata e bëjnë tërheqës trajnimin;
- Përgatitja dhe interesi i pjesëmarrësve, sa ata kanë interes rreth çështjeve që trajtohen, kjo është e lidhur ngushtë me etapën e parë të këtij procesi me përcaktimin e nevojave dhe sa janë të përgatitur pjesëmarrësit.

Kontrolli: Gjatë procesit të zhvillimit të trajnimit është e rëndësishme që në mënyrë permanente të ndiqet sa është realizuar dhe si janë realizuar objektivat që janë programuar për t'u realizuar. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet disa mënyrave:

- Testimi i reagimit të pjesëmarrësve gjatë zhvillimit të trajnimit, kjo nuk teston njohuritë e tyre, por mund të vlerësojë pozitivisht interesin e tyre, për çështje të veçanta dhe vlerësimin për trajnerë të veçantë;
- Testimi i njohurive, në fund të zhvillimit të seancave për çështje të caktuara;
- Shembuj konkretë duke punuar në grupe të vogla, vlerësimi i tyre;
- Debateve dhe konkluzioneve në fund të çdo seance, etj.

Vlerësimi i trajnimit: Vlerësimi i trajnimit është etapë me rëndësi, pasi mbledh të dhënat e nevojshme për të përcaktuar nëse procesi i trajnimit ishte i efektshëm.

Vlerësimi i programi i trajnimit: *(Plotësimi i pyetësorit të përgatitur nga trajnuesit, nga ana e audituesve, pjesëmarrës në trajnim)*

- Për të përcaktuar nëse trajnimi ka kontribuar në arritjen e qëllimeve të auditimit;
- Për të vlerësuar si dhe sa, të trajnuarit perfeksionuan njohuritë e tyre në këtë proces trajnimi;
- Për të vlerësuar metodat e përdorura në trajnim, nëse ato e ndihmuan të trajnuarin në arritjen e objektivave të trajnimit.
- Për të dizajnuar sa më mirë trajnimin e ardhshëm duke vlerësuar se ku ishin të metat dhe dobësitë e trajnimit të kryer.
- Për ta bërë në këtë mënyrë trajnimin një mjet sa më efikas
- Për të justifikuar koston e trajnimit, pasi KLSH investon në mënyrë që të përfitohen avantazhet e programuara.

Drejtore

Brunilda Zeneli

MIRATOI

DREJTORE E PËRGJITHSHME

MARIOLA LLANAJ